

VENDIM
Nr. 350, datë 20.3.2013

PËR AUTORIZIMIN E SHOQËRISË “BRECYLE” SHPK PËR IMPORTIN E MBETJEVE TË PLASTIKËS PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 22 pika 3 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar dhe të nenit 49 pika 2 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e shoqërisë “Brecycle” sh.p.k., për importin e mbetjeve të plastikës, me këto kode tarifore:

- | | |
|---------------------|---|
| - GH 010 3915 | - mbetje, prerjet dhe kthimet prej plastike; |
| - GH 011 ex 3915 10 | - prej polimereve të etilenit; |
| - GH 012 ex 3915 20 | - prej polimereve të stirenit; |
| - GH 013 ex 3915 30 | - prej polimereve të vinil kloridit; |
| - GH 014 ex 3915 90 | - prej plastikave të tjera (polimere ose bashkime polimeresh) |

dhe B3–B3010 të Konventës së Bazelit, aneksi 1 “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

2. Sasia e mbetjeve të plastikës që do të importohet, sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 4500 (katër mijë e pesëqind) tonë në vit. Mbetjet do të importohen nga Maqedonia, Kosova, Mali i Zi dhe vendet e Bashkimit European. Transporti do të bëhet në rrugë tokësore dhe detare, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave e të procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim e riciklim” dhe anekseve III dhe IV të vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

3. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve, “Brecycle” sh.p.k. dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në anekset III e IV të vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe monitorimi i tyre do të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

4. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve të plastikës nga “Brecycle” sh.p.k., është njëvjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit publik, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve të plastikës nga “Brecycle” sh.p.k., edhe pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon, me shkrim, me shtetet eksportuese dhe ato transitore, për autorizimet përkatëse që lejojnë kalimin e kësaj sasie të mbetjeve të plastikës, në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha